



# Manual mbi Praktikën Profesionale



*Ky dokument është zhvilluar nga Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin Aleksandër Xhuvani, Elbasan dhe Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër, me mbështetjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) si pjesë e projektit “Forcimi i kapaciteteve të studentëve të shkencave sociale dhe profesionistëve të shërbimeve sociale” që zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas”(LNB 2) dhe që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk janë domosdoshmërisht ato të UNDP-së apo Kombeve të Bashkuara (UN).*

## Përmbajtja

<b>Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>Seksioni 1. Informacion i përgjithshëm rreth manualit</b> .....	<b>5</b>
I. Sfondi.....	5
II. Rolet e stafit të përfshirë në praktikën mësimore .....	5
III. Ngjarjet kryesore që ndodhin gjatë praktikës mësimore.....	7
<b>Seksioni 2. Udhëzime për Studentët</b> .....	<b>10</b>
1. Udhëzime të përgjithshme.....	11
2. Reflektimet Kritike dhe Ditari.....	12
<b>Seksioni 3. Udhëzime për supervizorin e institucionit dhe/ose organizatës</b> .....	<b>16</b>
Të kuptosh kompetencat profesionale.....	17
Ku duhet të bazohet vlerësimi final i praktikës.....	18
Raporti i Vlerësimit të Praktikës .....	18
Vlerësimi i dosjes.....	19
Organizimi i punës së studentit dhe mjetet për komunikim të vazhdueshëm .....	19
<b>Seksioni 4. Politikat dhe procedurat për proceset e praktikës në terren</b> .....	<b>20</b>
Institucionet, kriteret e përzgjedhjes, të drejtat dhe detyrimet .....	20
Përzgjedhja e institucioneve/ organizatës së praktikës.....	20
Të drejtat dhe përgjegjësitë e institucionit /organizatës së praktikës .....	21
Politikat e përgjithshme të praktikës .....	21
Plotësimi i orarit dhe mungesat në praktikë .....	21
<b>Ndryshimi i praktikës</b> .....	21
Largimi i studentit nga praktika.....	22
Ecuri jo e kënaqshme në praktikën në terren.....	23
Aspekte organizative dhe parime të përgjithshme të praktikës në terren.....	23
Konfidencialiteti .....	23
Përfundimi i marrëdhënies me klientët.....	23
Kontrolli i sigurisë dhe infeksionit .....	23
Supervizimi i aktivitetit të studentit.....	24
Praktika për studentët me aftësi të kufizuara.....	24
Veshja .....	25
<b>Seksioni 5: Shtojcat</b> .....	<b>27</b>
Shtojca A: Një vështrim mbi kompetencat profesionale.....	27
Shtojca B: Formatet e vlerësimit.....	27
Shtojca C: Model reflektimi kritik mbi praktikën profesionale .....	27

## Hyrje

Disa nga njohuritë, shprehjet dhe aftësitë më të rëndësishme që përftohen gjatë realizimit të programit të edukimit të studentëve të shkencave sociale arrihen jashtë auditorit. Praktika profesionale, ose puna në terren, është një pjesë shumë e rëndësishme e kurrikulës. Ajo është një mundësi për të testuar njohuritë, për të mësuar, e për të vënë në praktikë vlerat dhe parimet profesionale në një mjedis mbështetës, si dhe ndihmon studentët të praktikojnë veten në një shumëllojshmërimundësish të karrierës profesionale.

Praktika nuk është një punë - është një mundësi profesionale ku studenti mëson se si *“të mendojë e të veprojë si profesionist”*. Studentët duhet të kuptojnë se çfarë do të thotë të bëhesh një profesionist, gjë e cila përfshin demonstrimin e sjelljes profesionale, si dhe përthithjen e rolit që ata luajnë në një mjedis mikpritës.

Për studentët fitimi i përvojës përmes punës në terren është një hap jetik, duke ofruar një mundësi për të përmirësuar aftësitë e nevojshme për të bërë një ndryshim. Ata mund të ndihmojnë në përmirësimin e jetës së individëve, si dhe të komuniteteve në të cilat ata jetojnë dhe punojnë.

Përvojat në terren i lejojnë studentët të zbatojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre në mjediset e botës reale – duke u njohur gjithashtu me kërkesat e praktikës në shkencë sociale.

Ky manual kërkon që studentët të realizojnë një edukim gjeneralist në terren, gjë që u lejon atyre të mësojnë dhe të demonstrojnë kompetencat thelbësore të profesionit (p.sh., duke përdorur parimet etike për të kryer praktikën) dhe një përvojë të avancuar në terren që u mundëson studentëve të demonstrojnë kompetencat në mjediset të avancuara gjeneraliste ose klinike. Manuali përcakton udhëzimet që Fakulteti i Shkencave Sociale duhet të ndjekë në drejtim të:

- Përzgjedhjes së institucioneve, organizatave për realizimin e praktikës.
- Monitorimit të studentëve ndërsa realizojnë praktikën.
- Ruajtjes së komunikimit ndërmjet universitetit dhe vendit të realizimit të praktikës.
- Vlerësimit të progresit të studentëve.
- Vlerësimit të efektivitetit të institucionit, organizatës në terren.
- Përcaktimit të kriterëve të supervisorëve të kualifikuar.

Manualii praktikës mësimore siguron udhëzime dhe një informacion të përgjithshëm mbi aspektet e praktikës të studentëve që ndjekin studimet bachelor dhe master në shkencë sociale. Manuali është i ndarë në seksione në mënyrë që studentët dhe Supervisorit i Praktikës të kenë lehtësisht akses ndaj informacionit që i duhet: gjithsesi ajo është e dobishme për të gjithë personat e përfshirë në praktikën mësimore. Manuali është i ndarë në pesë seksione si më poshtë:

Seksioni 1. Informacion i përgjithshëm rreth manualit. Përshkruan ngjarjet kyçe që ndodhin në praktikë dhe individët e përfshirë në të.

Seksioni 2. Informacion për studentët. Jep në detaje detyrat që studentët duhet të dorëzojnë gjatë praktikës mësimore.

Seksioni 3: Informacion për supervizorin e institucionit dhe pedagogun mbikëqyrës të praktikës. Përfshin informacionin që duhet të kenë supervizorët për kryerjen e vlerësimit të praktikës duke u bazuar tek kompetencat profesionale.

Seksioni 4. Politikat dhe Procedurat. Detajon politikat dhe procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit të praktikës.

Seksioni 5. Shtojcat. Formatet që duhet të plotësohen gjatë praktikës.

## Seksioni 1. Informacion i përgjithshëm rreth manualit

### I. Sfondi

Ky manual është përgatitur si një udhëzues për programin e praktikës profesionale të studentëve të shkencave sociale. Objektivat e manuali janë të:

- Ndihmojnë në orientimin e studentëve, supervizorit të institucionit dhe pedagogut mbikëqyrës me strukturën dhe procesin e programit të praktikës.
- Shpjegojnë politikën dhe procedurat që drejtojnë programin e praktikës.
- Shpjegojnë përgjegjësitë dhe pritshmëritë që ofrohen në kurrikulën e praktikës për studentët.

#### *Objektivat e programit të praktikës*

Objektivat e programit të praktikës profesionale janë të bazuara në standaret ndërkombëtare të praktikës së profesionistëve të shkencave sociale si punonjës socialë, psikologë, sociologë (AASË<sup>1</sup>, EFPA, APA). Ndaj gjatë praktikës profesionale studentët duhet të:

1. Eksplorojnë dhe shfaqin sjellje etike dhe gjithëpërfshirëse në mjedisin e institucionit të praktikës.
2. Të identifikojnë teoritë e shkencave sociale dhe ti lidhin ato me praktikën në mjedisin e institucionit të praktikës.
3. Të demonstrojnë njohuri dhe aftësi për të zbatuar një sërë detyrash dhe ndërhyrjesh, teknikash, metodash të punës brenda mjedisit të institucionit të praktikës.
4. Të njohin dhe shfaqin qëndrime, sjellje profesionale në vendin e punës dhe shprehi komunikimi (verbale, joverbale ose të shkruara) të përshtatshme për profesionistët e shkencave sociale veçanërisht në situata komplekse dhe sfiduese.
5. Të zbatojnë vet-reflektimin kritik të praktikës së tyre brenda supervizimit profesional.

### II. Aktorët kryesorë të përfshirë në praktikën profesionale

Në praktikën profesionale janë të përfshirë disa individë. Në shumë praktika ndërkombëtare ata marrin emra të ndryshëm. Më poshtë përshkruhen rolet që kanë individët kështu të përfshirë në procesin e praktikës: supervizori i institucionit cili është profesionisti që supervizon studentin në mjedisin e praktikës, pedagogu mbikëqyrës që është personi ndërlidhës midis institucionit dhe fakultetit, si dhe studenti që zhvillon praktikën. Disa nga rolet dhe përgjegjësitë që kanë janë përshkruar më poshtë.

---

<sup>1</sup>1. Vlerat dhe etika  
2. Profesionalizmi  
3. Praktikë kulturore e përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse  
4. Njohuri për praktikë  
5. Zbatimi i njohurive në praktikë  
6. Aftësitë komunikuese dhe ndërpersonale  
7. Regjistrimi dhe ndarja e informacionit  
8. Zhvillimi dhe mbikëqyrja profesionale

## **Supervizori i institucionit/ organizatës**

Një student në praktikë ka nevojë të ketë një supervisor që ta mbështesë, mësojë dhe vlerësojë. Zakonisht ky person punon në mjedisin ku studentit kryen praktikën dhe njihet si supervisor i institucionit/ organizatës.

Supervizori i institucionit është përgjegjës për menaxhimin dhe vlerësimin e të gjithë praktikës së studentit. Ai duhet të organizojë ndarjen e punës dhe mundësitë e të mësuarit që janë të përshtatshme dhe që do të mundësonin vlerësimin e kapacitetit të studentit.

### *Kriteret për përzgjedhjen e supervisorit të institucionit*

Institucioni/organizata duhet të zhvillojë një model të supervizimit që dallon nga roli i një supervisor në ambientin e punës. Duhet treguar kujdes në përzgjedhjen e supervisorëve nga institucionet/organizatat pritëse për të siguruar që studentët të marrin supervizim cilësor. Supervisor duhet të plotësojë të gjitha kriteret e nevojshme të një supervisor dhe roli i tij duhet të përcaktohet edhe në përshkrimin e punës si supervisor i praktikës së studentëve.

Kriteret e mëposhtme duhet të merren në konsideratë gjatë këtij procesi përzgjedhës:

1. Supervisor duhet të ketë: diplomë të nivelit master në një nga fushat e shkencave sociale;
2. Dy vite eksperiencë pune, nga të cilat një vit në vendin e punës ku po zhvillon supervizimin studentit; preferohet të ketë një eksperiencë të mëparshme të supervizimit të studentëve.
3. Të ketë njohje të mënyrës së organizimit të praktikës në mbështetje të misionit dhe filozofisë së praktikës profesionale.
4. Të angazhohet në mbështetjen e studentëve për të ndërlidhur teorinë me praktikën dhe të ketë një njohje të mirë të kompetencave profesionale. ( të shpjegura përgjatë manualit)

### *Rolet e supervisorit të institucionit/organizatës*

Supervisor ka rolet e mëposhtme:

- Të sigurojë një shkallë të gjerë mundësish dhe pune për të mësuar që të jetë në përshtatje me zhvillimin e studentit.
- Të sigurojë studentit një mjedis edukativ mbështetës dhe të sigurt pa ngacmime, shfrytëzime dhe shtypje.
- Të ofrojë studentit një orientim të përgjithshëm për institucionin/organizatën pritëse.
- Të sigurojë studentit supervizim të rregullt në lidhje me detyrat në terren.
- Të ndihmojë studentin në zhvillimin e të kuptuarit teorik dhe aplikimin në praktikë.
- Të informojë studentin nëse praktika e tij/saj nuk po plotëson standardet e kërkuara dhe të punojë me studentin për ta ndihmuar të përmirësohet. Kur është e nevojshme të ndjekë procedurat e problemeve me praktikën: performancës dhe progresit të dobët. ( Shih Seksionin IV)
- Të përgatisë Raportin për vlerësimin e praktikës.
- Të mbajë kontakte të vazhdueshme me pedagogun mbikqyrës të praktikës në lidhje me ecurinë e studentit apo dhe problemet e hasura.
- Të konfirmojë se i tërë materiali i përfshirë në dosjen e studentit është origjinal dhe anonim.

## **Pedagogu mbikëqyrësi praktikës**

Çdo student mbikqyret nga një pedagog, i cili është përgjegjës për të mbështetur studentin dhe ndërlidhë atë me institucionin dhe supervizorin përkatës gjatë gjithë kohëzgjatjes së praktikës:

Rolet e tij janë:

- Të mbështesë studentin për të identifikuar institucionin në përputhje me programin dhe nivelin e studimit.
- Të plotësojë formatin për Marrëveshjen e praktikës dhe të sigurohet që të gjitha palët kanë një kopje të firmosur dhe vulosur.
- Të prezantojë studentët me programin e praktikës dhe dokumentacionin përkatës.
- Në vijimësi të sigurohet se studentit po i ofrohen mundësi të përshtatshme, në përputhje me programin dhe marrëveshjen me qëllim përmbushjen e objektivave të praktikës.
- Të mbështesë studentin përmes udhëzimeve në realizimin e detyrimeve dhe në plotësimin e dosjes përfundimtare.
- Të mbështesë dhe udhëzojë studentin në rastet kur ai përballet me dilema etike dhe profesionale gjatë realizimit të praktikës.
- Të mbajë kontakte të vazhdueshme me supervizorin e praktikës.
- Të monitorojë procesin e realizimit të praktikës dhe detyrimeve të studentit.
- Të informojë Përgjegjësin e Departamentit në lidhje me ndonjë vështirësi që ka dalë në praktikë dhe të gjejë një zgjidhje.
- Të ofrojë vlerësim me notë për studentin në lidhje me praktikën.

## **Studenti**

- Të njohë dhe zotërojë Manualin e praktikës.
- Të ndjekë praktikën në mënyrë të rregullt dhe korrekte dhe në rastet e vonesave/mungesave të ndjekë procedurat e dakordësuara paraprakisht.
- Të ndjekë dhe kontribuojë në të gjitha mjediset e praktikës.
- T'i përmbahet politikave dhe procedurave që udhëheqin mjedisin e praktikës.
- Të silltet në përputhje me kodin e etikës së profesionit.
- Të plotësojë të gjitha detyrat që kërkohen për dosjen e praktikës.
- Të ngrejë çdo çështje që e shqetëson në lidhje me praktikën në një mënyrë profesionale në përputhje me procedurat për problemet mbi praktikën mësimore.

## **III. Ngjarjet kryesore që ndodhin gjatë praktikës mësimore**

### **1. Takimi para fillimit të praktikës**

Ky takim realizohet në mjedisin e praktikës përpara se praktika të jetë pranuar formalisht. Natyra dhe përmbajtja e takimit mund të variojë nga supervizori i institucionit: në disa raste ai mund të jetë informal, në disa të tjera ka natyrën formale të një interviste. Studenti duhet të përgatisë një



CV-(Curriculum Vitae) dhe të ketë informacion mbi institucionin dhe çfarë bëhet aty, si dhe të jetë i përditësuar mbi çështje që lidhen me shërbimet ndaj klientëve ose komuniteteve etj. Ky takim ka disa funksione:

- i jep mundësi studentit të sqarojë çdo paqartësi që ka ai në lidhje me mjedisin e praktikës dhe mundësitë që i ofron institucioni.
- është një mundësi e mirë për supervizorin e institucionit të zbulojë se çfarë interesash, aspiratash, nevojash dhe shqetësimesh mund të ketë studenti.

Në fund të takimit duhet të vendoset nëse institucioni ka rënë ose jo dakord që studenti të realizojë praktikën tek ta. Më pas pedagogu mbikëqyrës (nëse e sheh të arsyeshme mund të marrë pjesë në takimin e parë) informohet mbi emrin, adresën e institucionit dhe numrin e kontaktit të personit që do ndër marrë rolin e supervizorit të institucionit.

## **2. Takimi mbi Marrëveshjen e praktikës mësimore**

Ky takim mund të realizohet para ditës së parë të praktikës. Studenti nuk duhet ta fillojë praktikën pa nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Është thelbësore që studenti të ketë mundësi të ngrejë dhe diskutojë nevojat e tij për të mësuar dhe pritshmëritë që ka për praktikën. Takimi duhet të identifikojë dhe regjistrojë se si do plotësohen këto kërkesa në mjedisin e praktikës. Takimi drejtohet nga pedagogu mbikëqyrës dhe forma e Marrëveshjes së praktikës duhet të plotësohet përgjatë takimit.

Kjo është një marrëveshje që firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe drejtori i institucionit ku do realizohet praktika. Në kontratë ka disa elementë kyç ku përcaktohet se çfarë do mësojë studenti (disa objektiva bazë që studenti do përfitojë nga praktika në këtë institucion, sa kohë do përfshihet në vendin e praktikës, etj).

## **3. Procesi i njohjes dhe i të mësuarit me praktikën**

Nga të gjithë institucionet që ofrojnë praktikë për studentët pritet që të sigurojnë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për studentin. Pasi studenti fillon praktikën, institucioni duhet t'i ofrojë studentit një proces familjarizimi që zgjat një javë. Procesi i njohjes përfshin:

- njohje me politikat dhe procedurat kyçe të institucionit;
- njohje me politikat e sigurisë dhe shëndetit;
- familjarizim me shërbimet dhe stafin kyç të institucionit;
- njohje në komunitetet dhe institucionet/ organizatat lokale si dhe njerëzit/ grupet që i përdorin këto shërbime;
- njohje me metodologjinë e punës në këtë mjedis dhe target grupet përfituese;
- njohje me kontekstin historik të institucionit.

Institucionet janë të detyruara të sigurojnë shëndetin dhe sigurinë e studentit gjatë gjithë kohëzgjatjes së praktikës. Studenti duhet të trajtohet njësoj si çdo pjesëtar tjetër i stafit të institucionit në lidhje me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e tij/saj.

## **4. Takimi Final i praktikës**

Në këtë takim final marrin pjesë studenti dhe supervizori i institucionit (nëse dëshiron mund të marrë pjesë edhe pedagogu mbikëqyrës) dhe duhet të realizohet të paktën 5 ditë përpara ditës së fundit të praktikës.

Raporti i vlerësimit i supervizorit të institucionit duhet të jetë i plotësuar në këtë takim dhe studenti duhet të ketë plotësuar dosjen e tij me të gjithë dokumentet e nevojshme. Supervizori i

institucioniduhet të verifikojë se i gjithë materiali që është në dosjen e studentit është realizuar dhe i plotëson standardet. Ky takim konfirmon vlerësimin e dosjes së praktikës.

Kur bihet dakord se studenti e ka kaluar procesin e praktikës dhe se nuk ka nevojë për punë të mëtejshme, atëherë studenti e dorëzon dosjen në departament. Në të kundërt studenti realizon ndryshimet e nevojshme dhe më pas ia dorëzon dosjen pedagogut mbikëqyrës.

## Seksioni 2. Udhëzime për Studentët

### **Përmbajtja e Dosjes së Praktikës**

- ❖ Reflektimi kritik mbi praktikën
- ❖ Reflektimi mbi zhvillimin personal dhe profesional
- ❖ Ditari/ regjistrimet reflektive

## DOSJA E PRAKTIKËS

Studentët e praktikës duhet të plotësojnë një dosje që ndihmon në vlerësimin e kapaciteteve të tyre profesionale. Supervizori i institucionit duhet ta lexojë dhe ta firmosë këtë dosje dhe të vlerësojë autencitetin e punës së prezantuar nga studenti. Përmbajtja e dosjes është si më poshtë:

Seksionet e dosjes së praktikës dhe lista kontroll e materialeve që ajo duhet të përmbajë.	
Seksioni 1: Raporti i supervizorit të praktikës	<ul style="list-style-type: none"><li>• Vlerësimi i praktikës së studentit duke përdorur kompetencat profesionale shoqëruar me rekomandimet Kalon apo nukkalon</li></ul>
Seksioni 2: Reflektimet kritike	<ul style="list-style-type: none"><li>• Një Reflektim kritik mbi praktikën</li><li>• Një Reflektim kritik mbi zhvillimin profesional dhe personal</li></ul>
Seksioni 3: Dokumentacioni i dosjes	<ul style="list-style-type: none"><li>• Marrëveshja e praktikës (e firmosur, vulosur)</li><li>• Deklarata e konfidencialitetit</li><li>• Kalendari i ditëve të ndjekjes së praktikës</li></ul>

### 1. Udhëzime të përgjithshme

Studentët e praktikës duhet të plotësojnë një dosje, e cila ndihmon në vlerësimin e kapaciteteve të tyre profesionale. Dosja e përfunduar duhet të dorëzohet supervizorit të institucionit përpara ditës së përfundimit të praktikës.

I gjithë materiali i dosjes duhet t'i dërgohet me e-mail pedagogut mbikëqyrës në të njëjtën kohë që ajo i dorëzohet edhe supervizorit të institucionit.

Studenti pas takimit final të praktikës duhet të dorëzojë dosjen e përgatitur në Departament.

**Nëse studentit për arsye të ndryshme i duhet më shumë kohë për të përfunduar dosjen ai duhet ta negociojë këtë me pedagogun mbikëqyrës.**

Studenti duhet të sigurohet:

- Që fleta e Vlerësimit të supervizorit të praktikës të përfshihet në fillim të dosjes.
- Që kanë ndjekur strukturën e rekomanduar sipas seksioneve të Dosjes së Praktikës dhe sigurohen që të gjithë elementët e saj të identifikohen lehtësisht.
- Që në dosje çdo material është anonim dhe janë hequr të gjitha emrat e stafit apo organizatave të tjera.
- Që nuk ka asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e përdoruesve/ofruesve të shërbimeve të cilave i referohet.
- Që të gjitha dokumentet kanë firmat e kërkuara dhe janë firmosur nga të gjithë palët e përcaktuara.
- Që puna është e prezantuar në mënyrë profesionale.

**Studenti duhet të plotësojë 2 reflektime kritike gjatë praktikës profesionale.**

## 2. Reflektimet Kritike dhe Ditari

### ➤ Reflektimi kritik mbi praktikën – 2000 fjalë

Gjatë praktikës studenti duhet të shfaqë aftësi për të reflektuar në mënyrë kritike mbi punën e realizuar në mjedisin e praktikës. Kjo pjesë e detyrës duhet të bazohet më shumë në reflektim dhe analizë dhe më pak në përshkrim. Studenti duhet të bëjë një përshkrim të punës që ai ka realizuar dhe një përshkrim të shkurtër të rastit, por kjo gjë nuk duhet të përbëjë më shumë se 1/3 e të gjithë detyrës. Detyra duhet të jetë një reflektim dhe një analizë mbi praktikën dhe të mësuarin. Analiza duhet të marrë në konsideratë teorinë, legjislacionin, etikën dhe vlerat që shoqëruan punën e studentit. Studenti duhet të bëjë edhe një reflektim mbi aftësitë, metodat dhe përjasjet që ka përdorur.

Fushat kryesore që duhet të analizohen mbi reflektimin kritik të praktikës duhet të përfshijnë:

- Ambiguiteti/ paqartësitë
- Konfliktet
- Faktorë personal ku përfshihen ndjenja/shqetësime, paragjykime, frikëra, konflikte të brendshme etj
- Mbështetja nga kolegët, supervizori, të tjerët etj
- Krahasimet me rastet e tjera: Çfarë ka të re? Çfarë ka të ngjashme? Çfarë eksperiencash të kaluara ndikuan tek ju?
- Gabimet dhe sukseset
- Të mësuarit në të ardhmen.

### ➤ Reflektim kritik mbi zhvillimin personal dhe profesional (2000 fjalë)<sup>2</sup>

Studenti duhet të përfshijë në dosje një detyrë të shkruar e cila në mënyrë kritike reflekton zhvillimin personal dhe profesional gjatë praktikës. Për të realizuar këtë studenti duket të analizojë në mënyrë kritike një ngjarje që ka ndikuar thelbësisht mbi zhvillimin e praktikës, që ka bërë që të kuptojë si funksionojnë çështjet e etikës, dilemat dhe tensionet që ekzistojnë në procesin e punës së përditshme. Studenti duhet të tregojë se si elementët e mësipërme kanë ndikuar në aftësinë për të reflektuar mbi praktikën dhe rritjen profesionale. Kjo detyrë mund të përmbajë elementët e mëposhtëm dhe mund të bazohet tek ditari që studenti duhet të mbajë gjatë praktikës (Një format të ditarit e gjeni më poshtë). Kujdes: **Ditari është personal (nuk dorëzohet) por shërben për detyrat që studenti duhet të realizojë.**

- Një përshkrim i shkurtër i punës
- Aftësitë që studenti ka përdorur
- Aftësi të reja që ka mësuar ai
- Kompetencat profesionale që studenti ka treguar
- Teoritë që mund të aplikohen në punë
- Reflektim, dilemat dhe çështjet e diskutuara me Supervizorin e praktikës
- Ndjenjat dhe opinionet
- Zhvillimin dhe të mësuarit e shprehive
- Pikat e forta
- Zhvillimi i koncepteve të vlerave dhe etikës
- Roli i supervizimit efektiv
- Planifikimi i ndërhyrjeve në të ardhmen p.sh nevojat e mësimin dhe zhvillimit të vazhdueshëm.

---

<sup>2</sup> Një model e gjeni në shtojcë

## Udhëzime të mëtejshme për detyrat reflektuese


- ✓ Këto detyra duhet të vlerësohet nga supervizori i institucioni dhe pedagogu mbikëqyrës dhe ata duhet të vendosin nëse ajo i plotëson kriteret e nevojshme dhe do të jetë pjesë e dosjes së praktikës. Data e realizimit të kësaj detyre duhet të negociohet gjatëtakimit të Marrëveshjes së praktikës.
- ✓ Një kopje e kësaj detyre duhet t'i dërgohet me e-mail pedagogut mbikëqyrës të praktikës.
- ✓ Detyra duhet të ketë referenca akademike duke përdorur formatin e APA –së për referencat.
- ✓ Ju lutem sigurohuni që kjo detyrë të ruajë anonimitetin e punës duke siguruar konfidencialitetin e përdorueseve, ofruesve, të institucionit dhe çdo informacion tjetër që lidhet me dosjen e rastit.

## Reflektimi mbi praktikën

Donald Schön (1983) sugjeron se kapaciteti për të reflektuar mbi praktikën si një proces i vazhduar i të mësuarit është një nga elementët thelbësorë të praktikës profesionale. Praktika reflektive është një mënyrë për të analizuar eksperiencat, për të përmirësuar mënyrën se si punoni. Kjo i ndihmon studentët të kuptojnë se çfarë po bëjnë dhe pse po e bëjnë. Përfshirja në një praktikë reflektive të vazhdueshme ndihmon në përmirësimin e cilësisë së punës dhe të plotësojnë hendekun që ekziston midis teorisë dhe praktikës. Zhvillimi i aftësisë për të reflektuar mbi praktikën është një pjesë e rëndësishme e të mësuarit gjatë praktikës. Supervizori i institucionit ofron mbështetje për të reflektuar në mënyrë kritike duke qenë se është një aspekt i rëndësishëm i supervizimit. Ka shumë modele dhe mjete në internet që promovojnë zhvillimin e praktikës reflektive.

## Model shembull: Cikli i reflektimit i Gibbs

Cikli i reflektimit të Gibbs na inkurajon të mendojmë sistematikisht rreth fazave të një eksperience apo aktiviteti. Në këtë rast ju duhet të përdorni të gjitha pyetjet e mëposhtme për të strukturuar reflektimin tuaj.



Gibbs., G. (1988). *Learning by Doing: A manuale to teaching and learning methods*. Further Education Unit. Oxford Polytechnic: Oxford.

## Ditari/ ruajtja e shënimeve reflektive

Përgjatë praktikës, studentit i kërkohet të mbajë shënime reflektive mbi një bazë ditore dhe kjo duhet të diskutohet me Supervizorin e institucionit gjatë supervizimit. Shënimet duhet t'i lejojnë studentit dhe Supervizorit të institucionit të identifikojnë zhvillimin e aftësive dhe shprehive profesionale të studentit duke i kombinuar me aplikimin dhe integrimin e vlerave dhe etikës profesionale. Studenti duhet të fokusohet në një eksperiencë domethënëse të tëmësuarit, ndaj është e rëndësishme të monitorohet një eksperiencë dhe një zhvillim i tillë sepse përshtypjet mund të zhduken dhe të mësuarit mund të humbasë. Shënimet duhet të reflektojnë proceset e ndryshimit dhe zhvillimin profesional dhe do ta ndihmojnë studentin të plotësojë detyrat me shkrim të dosjes. Shënimet janë të nevojshme sepse e lejojnë studentin të masë zhvillimin e tij profesional dhe të eksplorojë aplikimin e teorive dhe zhvillimin e aftësive. Pjesë të caktuara të ditarit duhet të diskutohen me supervizorin e institucionit mbi një kalendar të përcaktuar që në fillim për tu lexuar dhe për të siguruar vlerësim. Ditari reflektiv është një mjet kryesor i të mësuarit për studentët.

Çështjet që mund të përdoren në një ditar reflektiv mund të përfshijnë:

- Detaje të shkurtra mbi punën e kryer
- Aftësitë që keni përdorur
- Aftësitë e reja që keni zhvilluar
- Kompetencat që keni shfaqur
- Vlerat që keni identifikuar në punën tuaj
- Teoritë e aplikueshme në punë
- Legjislacioni i përdorur ose që është i aplikueshëm
- Dilemat, çështjet dhe reflektimet që janë për tu diskutuar me supervizorin e institucionit
- Ndjenjat dhe opinionet.

## Një format që sugjerohet për ditarin:

Emri :		
Data :		
Numri i ditëve që keni në praktikë :		
Përshkrimin e ngjarjeve	Analiza	Plani i Veprimit/ Rezultatet e të mësuarit
<ul style="list-style-type: none"><li>• Çfarë bëtë, shikuat, dëgjuat?</li><li>• Si u përfshitë?</li><li>• Si u ndjetë?</li><li>• Çfarë bënë të tjerët, përdoruesit e shërbimeve, stafi dhe personat e tjerë të rëndësishëm?</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Çfarë mendoni rreth gjërave që keni mbajtur shënim?</li><li>• Çfarë teorish dhe politikash sociale ndikuan në këto ngjarje dhe ju ndihmuan ti kuptoni ato?</li><li>• Çfarë ndikimi kishit ju mbi ngjarjet?</li><li>• Sa mirë performuat?</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Çfarë do të donit të mësoni më shumë si rezultat i këtyre ngjarjeve dhe analizës suaj?</li><li>• Çfarë do të kishit bërë ndryshe?</li><li>• Çfarë keni ndërmend të bëni në vazhdim?</li></ul>





### **Seksioni 3. Udhëzime për supervizorin e institucionit /organizatës**

- **Njohuri mbi kompetencat profesionale**
- **Raporti mbi vlerësimin e praktikës së studentit**

## UDHËZIME PËR SUPERVIZORIN E INSTITUCIONIT DHE RAPORTET E VLERËSIMIT

Ekziston një format strikt për plotësimin e dosjes dhe studenti duhet t'i përmbahet atij. Dosja i lejon studentit të sigurojë të dhëna për:

- Aftësitë
- Njohuritë dhe integrimin e teorive në praktikë
- Aftësitë për të aplikuar vlerat dhe etikën profesionale
- Kapacitetin në lidhje me kompetencave profesionale

Dosja nuk është një katalog për të gjithë punën e bërë në praktikë, por kërkon që studenti të përzgjedhë të dhëna që demonstron aftësitë dhe njohuritë e tyre në lidhje me kompetencat profesionale dhe Kodin e Etikës.

Nga fillimi i praktikës deri në fund të saj supervizori i institucionit dhe studenti duhet të fillojnë të identifikojnë kërkesat që duhen për vlerësim dhe të marrin në konsideratë se si do ti demonstronjë studentët zhvillimin e tyre në lidhje me kompetencat profesionale dhe Kodin e Etikës. Supervizori i institucionit duhet të diskutojë rregullisht progresin e bërë në plotësimin e dosjes gjatë supervizimit.

### **Të kuptosh kompetencat profesionale**

Kompetencat profesionale përbëhet nga disa fusha dhe janë përshkruar të matshëm të performancës që përfshijnë njohuri, vlera dhe aftësi. Qëllimi është të demonstronjë integrimin dhe zbatimin e kompetencave në praktikë me individë, familje, grupe, organizata dhe komunitete. Disa nga kompetencat kryesore të renditura më poshtë përdoren për të funksionalizuar kurrikulën dhe metodat e vlerësimit.

1. Studenti demonstroi sjellje etike dhe profesionale.
2. Studenti promovon parimet etike dhe vlerat e profesionit si udhëzues profesional të praktikës profesionale.
3. Studenti pranon diversitetin dhe aplikon parimet anti-diskriminuese dhe anti-shtypëse në praktikë profesionale.
4. Studenti ka njohuri dhe promovon konceptet e të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale, mirëqenies ekonomike.
5. Studenti aplikon reflektimin dhe analizën kritike për tuzhvilluar dhe për të siguruar një vetëdije vendimmarrëse profesionale.
6. Studenti përdor gjykimin dhe autoritetin profesional për të realizuar ndërhyrje ndaj individëve, familjeve dhe komuniteteve, për të promovuar pavarësinë, për të siguruar mbështetje dhe për të parandaluar dëmtimet, neglizhimin dhe abuzimin.

Në fund të praktikës studenti duhet të demonstronjë një përdorim efektiv të njohurive, aftësive dhe angazhim ndaj vlerave kryesore profesionale në një mjedis të caktuar dhe në një situatë jo shumë komplekse, nën supervizim dhe mbështetje. Ai duhet të demonstronjë aftësi, njohuri dhe vlera për të punuar me një shumëllojshmëri grupesh, aftësi për të punuar me situata më komplekse; ai duhet të jetë në gjendje të punojë në mënyrë të pavarur, por sërish vendimi përfundimtar i mbetet supervizorit.

Progresi midis niveleve karakterizohet nga zhvillimi i aftësisë së studentit për të menaxhuar kompleksitetin, riskun, ambiguitetin dhe rritjen e autonomisë për të marrë vendime përgjatë shumë situatave. Kompetencat profesionale i jepin mundësi studentit të demonstronjë progresin—që nga

fillimi, përgjatë praktikës dhe në fund të saj. Supervizori ka një rol kryesor në vlerësimin holistik të studentin duke u mbështetur në kompetencat profesionale.

### **Ku duhet të bazohet vlerësimi final i praktikës?**

Studentit i kërkohet që të kuptojë kapacitetet profesionale, të demonstrojë se si është zhvilluar praktika e tyre dhe të analizojë dhe reflektojë në mënyrë kritike mbi profesionin. Ekzistojnë një sërë mundësish përgjatë praktikës që studenti të shfaqë zhvillimin e tij dhe këto mundësi mund të informojnë dhe sigurojnë një të dhënë mbështetëse për vlerësimin holistik të supervizorit:

- **Supervizimi reflektiv.** Supervizori i institucionit mund të dëshirojë të diskutojë me studentët punën e tyre direkte me përdoruesit e shërbimeve dhe zhvillimin e aftësive të tyre vlerësuese, planifikuese dhe ndërhyrëse. Gjithashtu ai mund të dëshirojë të diskutojë aspekte të ndryshme të kapaciteteve profesionale të shkencave sociale si –njohuritë teorike të studentit; kuptueshmërinë e tyre mbi diversitetin, strategjitë anti-diskriminuese dhe vlerat; të kuptuarin e tyre mbi praktikën multi profesionale dhe përdorimin e autoritetit. Studenti duhet të inkurajohet të reflektojë mbi punën e tyre në praktikë dhe supervizimi siguron një mundësi që kjo të diskutohet. Një supervizim dhe diskutim reflektiv siguron një burim të vlefshëm për të informuar supervizorin të bëjë vlerësimin e progresit të studentit.
- **Reflektimi kritik dhe analiza.** Kjo është një nga fushat thelbësore për shkencat sociale. Supervizori i praktikës duhet të inkurajojë studentin të përfshihet në reflektim dhe analizë kritike në lidhje me aspekte të punës në praktikë dhe supervizimi duhet të jetë çelësi i kësaj detyre. Pyetje të thjeshta si : Çfarë bëtë? Si e bëtë? Pse e bëtë? Si shkoi? Pse nuk shkoi sikurse e parashikuat? Çfarë mësuat nga kjo? mund ta ndihmojnë studentin të reflektojë mbi praktikën e tij sesa mbi ngjarjen dhe të shpjegojë dhe vlerësojë veprimet dhe vendimet e tij. Supervizori i institucionit duhet të inkurajojë studentin të mbajë një ditar dhe të ndajë elementë të tij përgjatë supervizimit reflektiv. Kjo do reflektojë zhvillimin e kuptueshmërisë së studentin për rolin profesional dhe do të ndihmojë supervizorin në vlerësimin e zhvillimit të kompetencave profesionale të studentit.
- **Kuptim i teorisë në praktikë.** Studentit i kërkohet të kuptojë teorinë që formojnë praktikën dhe të demonstrojë aplikimin e tyre në terren. Kjo demonstron në punën që ata realizojnë për dosjen e praktikës por duhet të diskutohet dhe inkurajohet gjatë supervizimit.

### **Raporti i Vlerësimit të Praktikës**

Vlerësimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm përgjatë gjithë praktikës. Ai përbëhet nga vlerësimi i pedagogut mbikëqyrës dhe vlerësimi final i supervizorit të institucionit. Vlerësimi final lejon një rishikim të përgjithshëm të të gjithë dokumentacionit që duhet të dorëzohet studentit. Inkurajohet që supervizori dhe studentit ta bëjnë procesin e vlerësimit sa më bashkëpunues të jetë e mundur, duke diskutuar hapur ecurinë e studentit dhe fushat për rritje/përmirësim.

Vlerësimi dhe gjykimi i studentit i bërë nga supervizori duhet të udhëhiqet nga ndershmëria, transparenca dhe mjaftueshmëria.

- ✓ *Ndershmëria* - procesi i vlerësimit duhet të bazohet në një të kuptuar të qartë që del nga udhëzimet dhe pritshmëritë e këtij manuali dhe që janë në përputhje me kompetencat profesionale.
- ✓ *Transparenca* - Supervizori duhet të jetë konsistent në vlerësimin e studentit në linjë me kompetencat profesionale që janë të përshkruara në shtojcë. Kështu, nëse ka pasur fusha shqetësuese ose që ka pasur nevojë për zhvillim ato duhet të jenë të dokumentuara. Nëse janë identifikuar shqetësime të vazhdueshme mbi të mësuarin ose performancën e studentit është thelbësore të ndiqen Procedurat e Shqetësimeve (shih seksionin e Politikave dhe Procedurave)

- ✓ *Mjaftueshmëria* - Supervizori duhet të sigurohet se ka të dhëna të mjaftueshme ku mund ta mbështesë gjykimin profesional dhe vlerësimin e studentit. Studenti ka rolin e tij në sigurimin e të dhënave të tilla (si rezultatet e punës, elementët e dosjes etj), por supervizori duhet të bazohet edhe në të dhëna të llojeve të tjera për të bërë vlerësimin e tyre.

### **Vlerësimi i dosjes**

Supervizori i institucionit bën një rekomandim për studentin, të llojit: **kalon/ nuk kalon**. Ai/ ajo vlerëson dhe sheh nëse është autentike puna e bërë në dosje dhe shkruan raportin e tij (shih formularin në shtojca).

Pedagogu mbikqyrës është përgjegjës për kontrollin e dosjes dhe vlerësimin me notë të studentit në përputhje me vlerësimin e supervizorit të institucionit.

### **Organizimi i punës së studentit dhe mjetet për komunikim të vazhdueshëm**

Organizimi i punës së studentit duhet të realizohet duke u udhëhequr nga disa parime etike dhe profesionale në përputhje me objektivat e programit të lëndës dhe me nevojat e institucioneve pritëse. Pritet që studentët të marrin seriozisht angazhimin e tyre ndaj klientëve, aktiviteteve të institucionit si dhe bashkëpunimin me supervizorin e institucionit dhe me pedagogun mbikqyrës. Studentët duhet të sillen në një mënyrë profesionale dhe etike në ndërveprimet e tyre me stafin, fakultetin dhe klientët, duke u kujdesur që të jenë në përshtatje me nevojat e ndryshme të institucioneve pritëse. Gjatë praktikës profesionale synohet që studentët të zhvillojnë disiplinën profesionale, të identifikojnë rolin e tyre në institucion në përputhje me formimin e tij akademik si dhe zhvillimin e kompetencave në marrjen e këtij roli. Studentët duhet të konsultohen me Kodin e Etikës të profesionit të tyre për sqarime dhe udhëzime, duke marrë parasysh faktin se Kodi i Etikës është relevant për të gjithë profesionistët, pavarësisht nga funksionet e tyre profesionale, vendet në të cilat punojnë, ose popullatat që u shërbejnë.

## Seksioni 4. Politikat dhe procedurat për procesin e praktikës në terren

### Organizimi i praktikës sipas kurrikulës mësimore

Organizimi i praktikës sipas kurrikulës mësimore përbëhet nga praktika në terren dhe seminari integruar i quajtur praktikum (vetëm në nivelin Bachelor) që realizohet në fakultet prej një ose dy orësh në javë. Mendohet se ky lloj plani i adreson më mirë nevojat e studentëve në disa mënyra:

- Ai ofron potencialin maksimal për koordinim ndërmjet klasës dhe udhëzimeve në terren, duke theksuar marrëdhëniet midis teorisë dhe praktikës.
- Ai ofron një mundësi më të hershme për studentët që të lidhin teorinë me praktikën profesionale dhe çështjet e saj.
- Ky është një format në të cilin studentët kanë një mundësi të shkëlqyer për të zhvilluar aftësitë ndërvepruese dhe analitike në bazë të të pasurit të një praktike në terren me kohëzgjatje më të gjatë, që përfshin dy semestra.

### Institucionet, kriteret e përzgjedhjes, të drejtat dhe detyrimet

#### Përzgjedhja e institucioneve dhe / ose organizatës të praktikës

Për të kryer një praktikë në terren në fushën e shkencave sociale, është e rëndësishme të identifikojmë një mjedis të përshtatshëm që ofron një platformë të mirë për zhvillimin e praktikës. Këtu janë disa elementë dhe kriteret që mund të merren në konsideratë: P.sh: shërbimet e ofruara, përfituesit, stafi i punonjësve në shërbimin psiko-social, nivelet e licencimit, eskperienca të mëparshme në ofrimin e praktikës për studentët e shkencave sociale, etj. Kriteret e mëposhtme përdoren për zgjedhjen e institucioneve në terren për realizimin e praktikës së studentëve:

- Misioni, vizioni dhe standardet e institucionit janë në përputhje me profesionet e shkencave sociale, si dhe edukimin në shkencat sociale.
- Institucioni e sheh pjesëmarrjen në arsimimin e studentëve të shkencave sociale universitare si i vlefshëm dhe pranon të mbështesë qëllimet dhe objektivat e Fakultetit të Shkencave Sociale.
- Institucioni është i gatshëm për të strukturuar përvoja të përqendruara në edukim, të cilat janë të përshtatshme për nevojat edukative të studentit dhe ofrojnë mundësi për të punuar me sisteme klientësh me madhësi të ndryshme (p.sh. individë, familje, grupe, komunitete), me ekspozim ndaj një shumëllojshmërie njerëzish.
- Institucioni përmbush udhëzimet e përgjithshme si një organizatë e shërbimit social që mundëson praktikën e studentëve. Institucionet u ofrojnë studentëve përvoja të ndryshme praktike.
- Institucioni ka dhe është në përputhje me politikën në lidhje me mosdiskriminimin në ofrimin e shërbimeve dhe punësimi në lidhje me seksin, racën, origjinën kombëtare ose etnike, fenë, paaftësinë, moshën, klasën, seksualitetin dhe orientimin afeksional, besimin politik apo statusin e veteranit.
- Institucioni është i gatshëm të angazhojë burimet e nevojshme për përvojën praktike të studentëve, p.sh.: kohën e mbikëqyrjes, hapësirën fizike të përshtatshme, përfshirje në ofrimin e shërbimeve, etj.

## **Të drejtat dhe përgjegjësitë e institucionit dhe/ose organizatës të praktikës**

Më poshtë është lista e të drejtave dhe përgjegjësiave të institucionit të praktikës:

- Siguron një përvojë praktike dhe mundësi edukuese të shprehive profesionale për studentët e shkencave sociale.
- I ofron studentit orientimin e duhur ndaj personelit, politikave dhe procedurave të institucionit.
- Shfaq kompetencë dhe stabilitet në ofrimin e shërbimeve profesionale dhe ofron klimë të favorshme për mësimin dhe zhvillimin profesional të studentit.
- Njofton menjëherë pedagogun mbikëqyrës kur një student përjeton probleme serioze në institucion dhe jep njoftim me shkrim dhe arsyetim kurnjë studenti i kërkohet të largohet nga institucioni.
- Konsideron studentin edhe si nxënës edhe si pjesëmarrës aktiv në shërbimet dhe aktivitetet e saj.
- Mund të refuzojë të pranojë një student për arsye që lidhen me ndryshime në vlera, perceptime, ose sjellje, dhe mund të ndikojnë negativisht në mjedisin e përgjithshëm të institucionit.
- Mund të kërkojë largimin e menjëhershëm të një studenti, i cili është identifikuar si rrezik për klientët në institucion ose që shkel konfidencialitetin.

## **Politikat e Përgjithshme të Praktikës**

Ekzistojnë disa politika të përgjithshme të cilat u referohen të gjithë studentëve gjatë praktikës në terren. Këto janë përmbledhur në fushat e mëposhtme.

### **Plotësimi i orarit dhe mungesat në praktikë**

1. Nëse studenti mungon në praktikën në terren, ai/ajo ka përgjegjësinë që të komunikojë me supervizorin përpara se ai të marrë mungesat. Supervizori duhet të njoftojë departamentin për çdo shqetësim në lidhje me mungesën e studentit.
2. Procedurat për këto raste iu referohen parashikimeve sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës dhe syllabusit të lëndës.

### **Ndryshimi i praktikës**

Në vijim janë politikat në lidhje me ndryshimin e vendit të realizimit të praktikës nga studentët apo nga institucioni:

1. *Nëse studenti e sheh institucionin si jo të përshtatshëm për zhvillimin e tij profesional:*

a. Studenti duhet të flasë me pedagogun përgjegjës mbi shqetësimin. Nëse këto çështje mund të zgjidhen në favor të të gjithëve dhe studenti vendos të qëndrojë në institucion, nuk vepronet me tej. Ky proces sugjerohet të konsiderohet si konsultë e përbashkët me të gjithë palët e interesuara.

b. Nëse studenti dëshiron ta ndryshojë institucionin e praktikës, pedagogu mbikëqyrës duhet ta diskutojë situatën me Përgjegjës të Departamentit për të sqaruar statusin e studentit në institucion.

c.Studenti dhe/ose pedagogu mbikëqyrës në këtë pikë mund të zgjedhin të flasin drejtpërdrejt me supervizorin.

d. Nëse është marrë vendimi për ta lëvizur studentin, duhet të kontaktohet me një institucion të përshtatshëm dhe të arrihet në një marrëveshje në mënyrë që studentit të fillojë praktikën atje.

2. *Në rast se institucioni kërkon largimin e studentit për çfarëdo arsye:*

a.Përgjegjësi i Departamentit do të diskutojë me pedagogun mbikëqyrës dhe/ose studentin situatën që arriti në këtë kërkesë të institucionit.

c.Nëse është e mundur që studentit të qëndrojë deri në fund të semestrit, me supervizim të veçantë nga Fakulteti, atëherë do të ishte më mirë për studentin. Nëse kjo nuk është e mundur, zëvendësimi i studentit do të ndjekë udhëzimet sipas pikës 1 (d).

3. *Në rast se Departamenti e shikon të arsyeshme largimin e studentit:*

a.Me gjasë kjo lloj kërkesë vjen nga pedagogu mbikëqyrës, i cili do të njoftojë Përgjegjësin e Departamentit.

b.Kjo do të diskutohet me studentin dhe Supervizorin e institucionit.

c.Në momentin që është marrë vendimi për largimin e studentit, vendosja e studentit në një mjedis tjetër praktikë, ndiqen udhëzimet e pikës 1 (d).

### **Largimi i studentit nga praktika**

Studenti mund të largohet nga praktika në terren në rrethanat e mëposhtme:

1. *Me kërkesë të studentit.*

2. *Vendim të Përgjegjësit të Departamentit, duke përfshirë rekomandimin e pedagogu mbikëqyrës dhe supervizorit të institucionit. Më poshtë janë bazat për largimin e studentit nga praktika në terren:*

a.dështimi për të ruajtur konfidencialitetin e një klienti ashtu si urdhërohet nga rregullat e institucionit / organizatës dhe/ose Kodin e Etikës.

b.dështimi për të respektuar Kodin e Etikës dhe si dhe rregulloret dhe procedurat përkatëse;

c.një përpjekje për të dëmtuar veten;

d.një përpjekje për të dëmtuar dikë tjetër;

e.vonesa të vazhdueshme në institucion dhe/ose vonesa pa lajmëruar;

f.mungesa të vazhdueshme në institucion dhe/ose mungesa pa lajmëruar;

g.ndryshime të vazhdueshme të orëve të përcaktuara të punës në terren pa miratim të mëparshëm; dhe/ose

h.sjellja e papërshtatshme në lidhje me zbatimin në terren të udhëzimeve nga supervizori i institucionit.

Vendimi përfundimtar në lidhje me largimin nga institucioni bëhet nga Përgjegjësi i Departamentit, mbi bazën e dokumentacionit të ofruar nga supervizori, institucioni dhe pedagogu mbikëqyrës. Studenti mund ta apelojë vendimin duke ndjekur udhëzimet e Departamentit.

Nëse studentit do të lejohet të rikthehet në praktikën në terren në të njëjtën institucion apo në ndonjë institucion tjetër, kjo varet nga serioziteti i incidentit dhe/ose mundësia e studentit për të zgjidhur problemin. Departamenti përkatës dhe stafi i tij do të ketë përgjegjësinë që të punojë me studentin rreth situatës dhe mund të vendosë kushte për rikthimin e tij në praktikën në terren.

### **Ecure jo e kënaqshme në praktikën në terren**

Kur një student nuk po përparon me një ritëm të kënaqshëm:

- a. Supervizori i institucionit duhet të lajmërojë pedagogun mbikëqyrës sapo të pikasë ndonjë problem.
- b. Pedagogu mbikëqyrës duhet të organizojë menjëherë një takim me supervizorin e institucionit.
- c. Studenti, supervizori dhe pedagogu mbikëqyrës i praktikës përfshihen në analizën e problemit.
- d. Studentit i jepet njoftim formal se performanca është nën standartet e kërkuara.
- e. Studentit i jepen udhëzime specifike që ai duhet ti ndjekë nëse dëshiron të rrisë standartin e performancës së tij/saj. Këto i jepen studentit me shkrim dhe mund të përbëjnë një rishikim të nivelit të përcaktuar nga pedagogu mbikëqyrës (informacion i mëtejshëm mbi sistemin e rishikimit të nivelit të ecurisë do të duhet të kërkohej rast pas rasti).

### **Aspekte organizative dhe parime të përgjithshme të praktikës në terren**

#### **Konfidencialiteti**

Studentëve u kërkohet të ndjekin standardet dhe udhëzimet brenda Kodit të Etikës në lidhje me konfidencialitetin. Studentëve u kërkohet të ndjekin udhëzimet e konfidencialitetit të institucionit dhe t'ia transmetojnë ato klientëve / marrësve të shërbimeve sipas protokollit dhe procedurave të institucionit. Studentët janë përgjegjës për të mësuar dhe kuptuar politikën e konfidencialitetit të institucionit, ata duhet të nënshkruajnë çdo formular të konfidencialitetit të institucionit gjatë praktikës dhe duhet ta respektojnë atë gjatë dhe pas përfundimit të praktikës.

#### **Përfundimi i marrëdhënies me klientët**

Klientët me të cilët një student punon gjatë punës në terren janë klientë të institucionit dhe jo të studentit. Studentët duhet të përfundojnë marrëdhëniet në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me politikën dhe procedurat e institucionit me të gjithë klientët, në fund të praktikës.

#### **Kontrulli i sigurisë dhe infeksionit**

Siguria është një fushë në të cilën studentët janë gjithnjë në risk. Ka një numër në rritje të institucioneve dhe organizatave ku praktikantët punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me target grupe potencialisht të dhunshme. Studentët e praktikës gjithashtu udhëtojnë në lagje të ndryshme për të kryer vizita në shtëpi si pjesë e procesit mësimor.

Gjithashtu, mund të ketë situata ku studentët të mund të jenë të ekspozuar ndaj sëmundjeve infektuese. Kjo është një çështje që kryesisht prek studentët e vendosur për praktikë në institucionet që u shërbejnë të pastrehëve, personave me HIV/AIDS apo grupeve të tjera me rrezikshmëri të lartë. Studentët potencialisht mund të ekspozohen ndaj Hepatitit, TB, HIV, dhe/ose sëmundjeve të tjera infektuese. Si



partnerë në edukim, institucioni, studenti dhe departamenti ndajnë përgjegjësitë për t'u siguruar që mjedisi i punës është një vend i sigurt.

Në përpjekje për të siguruar shëndetin fizik dhe sigurinë e një praktikanti, pikat në vijim janë të nevojshme për institucionin/ organizatën, studentët dhe pedagogun mbikëqyrës:

#### **Institucioni:**

- Informon studentët për rreziqe të mundshme të sigurisë, rreziqet e mundshme shëndetësore që mund të ekzistojnë në terren, etj.
- Ofron trajnim mbi sigurinë. Kjo përfshin trajnime që lidhen me komunikimin efektiv me klientët, teknikat e e përshkallëzimit të konfliktit, trajnime dhe edukim për masat universale të projektuara për të zvogëluar rrezikun e infeksioneve të mundshme etj.
- Njofton pedagogun mbikëqyrës dhe/ose departamentin në rast se një student është i përfshirë në një incident të dhunës fizike dhe/ose agresionit të kryer nga një klient, në rast të ndonjë incidenti lidhur me sigurinë duke përfshirë ekspozimin e studentit ndaj një sëmundje ngjitëse si turbekulozi apo hepatiti etj.
- Ndërmerr hapa për të përmirësuar sigurinë e mjedisit të punës, duke përfshirë sigurimin e udhëzimeve të sigurisë për të punuar me klientë si në zyrë ashtu edhe në shtëpinë e klientit.

#### **Studenti:**

- Kërkon trajnim për kontrollin dhe sigurinë nëse nuk ofrohet nga institucioni.
- Ndjek udhëzimet për kontrollin e sigurisë dhe infeksioneve.
- Raporton incidente të ekspozimit ndaj infeksionit dhe të cënimit të sigurisë në institucion ose /dhe gjatë punës në terren

#### **Pedagogu mbikëqyrës**

- Ofron trajnime mbi sigurinë dhe kontrollin e infeksioneve gjatë praktikës në terren.
- Monitoron faktorët e rrezikut gjatë vizitave në institucionet përkatëse.
- Komunikon incidentet lidhur me sigurinë tek Përgjegjësi i Departamentit.
- Mbikqyr çështjet lidhur me sigurinë dhe shëndetin ndërmjet supervisorëve të praktikës dhe studentëve.

#### **Supervizimi i aktivitetit të studentit**

Studentët nuk duhen lënë vetëm në institucion pa pasur prezent staf profesional. Gjithashtu, nuk është e këshillueshme të lihen studentët vetëm gjatë mbledhjeve apo konferencave, pasi mund të krijojnë konfuzion. Pavarësisht sa të aftë apo kompetentë janë, studentët nuk janë të përgatitur për të marrë përsipër këto lloj përgjegjësish.

#### **Praktika për studentët me aftësi të kufizuara**

Një person me aftësi të kufizuara quhet: "... një individ që ka një dëmtim fizik ose mendor i cili ndikon në aftësinë e tij për të kryer aktivitetet normale ditore". Ndikimi duhet të jetë:

- i konsiderueshëm dhe
- afatgjatë (që është, ka zgjatur ose ka të ngjarë të zgjasë për të paktën 12 muaj ose për pjesën tjetër të jetës së personit të prekur) dhe

Politikat aktuale të arsimit në të gjithë vendet perëndimore kërkojnë që:

- Të mos diskriminohen studentët me aftësi të kufizuara

- Të zbulohen nevojat e mundshme të studentit
- Të bëhen rregullime të arsyeshme

Fakulteti i Shkencave Sociale është i angazhuar për të siguruar që nevojat specifike të studentëve me aftësi të kufizuara të merren parasysh dhe që të gjithë studentëve t’ju jepet akses dhe t’ju mundësohen mjedise praktike që i plotësojnë këto nevoja. Megjithatë, siguria e përdoruesve të shërbimeve sociale është primare dhe kjo duhet të marrë përparësi edhe mbi nevojat e të nxëniet të studentëve me aftësi të kufizuara. Studentët, duhet të kenë në konsideratë që të diskutojnë nevojat që dalin nga ndonjë paaftësi sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kur një student zbulon se ai / ajo ka një aftësi të kufizuar, pedagogu mbikëqyrës:

- Konsultohet me studentin rreth natyrës së mbështetjes/ akomodimit që kërkohet për mjedisin e praktikës.
- Bie dakord me studentin, se si dhe se sa informacion në lidhje me paaftësinë e tyre duhet të ndahet me stafin e praktikës.
- Kur është e nevojshme, sigurohet monitorim shtesë për të siguruar përshtatshmërinë e mbështetjes/ akomodimit.

Shembuj të llojeve të rregullimeve dhe mbështetjeve që mund të ofrohen përfshijnë:

- Përshtatje fizike (p.sh rampat etj)
- Sigurimi i pajisjeve të specializuara (p.sh diktofonë për marrjen e shënimeve)
- Përshtatja për burimet IT dhe / ose përdorimin e softuerit të specializuar
- Rregullimet e ritmit të një praktike, p.sh shkurtime të orëve për të minimizuar lodhjen. (Kjo do të çojë në zgjatjen e praktikës duke marrë më shumë javë për të plotësuar numrin e kërkuar të ditëve)

Studentët duhet të bashkëngjitin një kopje të planit të tyre mbështetës ose të sigurojnë një përmbledhje të rregullimeve të nevojshme në formatin e tyre të aplikimit për praktikën. Kur studenti ka siguruar një përmbledhje ai duhet ta ndajë të gjithë planin e mbështetjes me supervizorin e institucionit dhe pedagogun mbikëqyrës në rastin më të parë, (p.sh në vizitën joformale). Kërkesat për mbështetje dhe akomodime mund të përfshihen në Marrëveshjen e e Praktikës gjatë takimit të parë.

### **Veshja**

Studentët pritet të vishen në mënyrë të përshtatshme gjatë praktikës. Mjedise të ndryshme të praktikës kërkojnë forma të ndryshme veshjeje, për shembull punë rezidenciale, punë me të rinjtë në komunitet ose gjykata. Disa vende mund t’ju kërkojnë të visheni në një mënyrë që i përshtatet kulturës së komunitetit/ grupit që do punoni. Nëse ka ndonjë paqartësi /mosmarrëveshje, supervizori duhet ta diskutojë këtë me studentët.



## **Seksioni 5: Shtojcat**

**Shtojca A: Njëvështrim mbi kompetencat profesionale**

**Shtojca B: Formatet e vlerësimit**

**Shtojca C: Model reflektimi kritik mbi praktikën profesionale**

## Shtojca A: Njëvështrim mbi kompetencat profesionale

### Kompetencat profesionale në shkenca sociale

Ky dokument paraqet në formë me te detajuar kompetencat profesionale që nga fillimi i praktikës deri në finalizimin e saj – kështu që është më e lehtë për studentin dhe supervizorin e institucionit të shohë përparimin nga një nivel në tjetrin.

Shtatë fushat janë interaktive - ata punojnë së bashku për të përshkruar njohuritë, aftësitë dhe vlerat profesionale që duhet të praktikohen në mënyrë efektive. Ato tregojnë se si duhet të zhvillohen njohuritë e studentëve, vlerat dhe aftësitë e tyre gjatë praktikës.

#### 1. Profesionalizmi: Studenti demonstroi sjellje etike dhe profesionale. Ai identifikohet dhe sillet si një profesionist i përkushtuar ndaj zhvillimit profesional.

- Të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e rregullave profesionale.
- Të jetë në gjendje të shpjegojë rolin e profesionit në një gamë kontekstesh dhe të mbrojë reputacionin e profesionit
- Të demonstrojë profesionalizmin në aspektin e paraqitjes, sjelljes, besueshmërisë, ndershmërisë dhe respektit
- Të marrë përgjegjësinë për menaxhimin e kohës dhe ngarkesës së punës në mënyrë efektive, dhe të fillojnë të vendosin prioritetet e aktivitetit të tyre, duke përfshirë dhe kohën e mbikëqyrjes
- Të njohë ndikimin e vetes në ndërveprim me të tjerët, duke përdorur në mënyrë të duhur përvojat e eksperiencat personale
- Të jetë në gjendje të njohë dhe të ruajë kufijtë personal dhe profesional
- Të njohë kufizimet profesionale dhe mënyrat se si të kërkojë këshilla
- Të demonstrojë një angazhim ndaj të mësuarit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional
- Me udhëzime, të marrë hapa për të menaxhuar dhe për të promovuar sigurinë e tyre, shëndetin, mirëqenien dhe reziliencën emocionale
- Të identifikojë shqetësimet rreth praktikave dhe procedurave dhe, me mbështetje, të fillojnë të identifikojnë mjetet e duhura sfiduese.

#### 2. Vlera dhe Etika: Studenti promovon parimet etike dhe vlerat e profesionit si udhëzues profesional të praktikës profesionale

- Të kuptojë dhe zbatojë parimet etike të profesionit dhe të legjislacionit, duke i marrë ato në konsideratë në arritjen e vendimeve.
- Të njohë dhe me mbështetje të menaxhojë ndikimin e vlerave të tyre në praktikën profesionale
- Të menaxhojë vlerat potencialisht konfliktuale ose konkurruese dhe me udhëzim, të njohë, të reflektojë mbi to dhe të punojë me dilemat etike
- Të demonstrojë punë të respektueshme partneriteti me përdoruesit e shërbimit dhe ofruesit, të identifikojë dhe të respektojë nevojat dhe pikëpamjet e tyre, si dhe të promovojë nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje kudo që ajo të jetë e mundur
- Të njohë dhe të promovojë të drejtat e individëve për autonomi dhe vetëvendosje
- Të promovojë dhe të mbrojë privatësinë e individëve brenda dhe jashtë familjeve dhe rrjeteve të tyre, duke pranuar kushtet dhe kërkesat e përgjegjësisë profesionale dhe të ndarjes së informacionit

#### 3. Diversiteti dhe Barazia: - Njohja e diversitetit dhe zbatimi i parimeve anti-diskriminuese dhe anti-shtypëse në praktikë

- Të njoh rëndësinë e diversitetit në identitetin dhe eksperiencën njerëzore, dhe aplikimin e parimeve anti-diskriminuese dhe anti-opresive
- Të kuptojë se si identiteti i një individi është formuar nga faktorë të tillë si kultura, gjendja ekonomike, përbërja familjare, përvojat e jetës dhe karakteristikat, si dhe të marrë në konsideratë këto elementë për të kuptuar eksperiencat e tyre jetësore, si dhe për të testuar dyshimet kur kjo gjë është e mundshme
- Bazuar në kërkesat aktuale legjislative, të njohë diskriminimin dhe shtypjen personale dhe organizative, dhe të identifikojë mënyrat me të cilat ato mund të sfidohen
- Të njohë dhe të menaxhojë ndikimin e pushtetit të njerëzve në rolet tuaja profesionale

#### **4. Studenti ka njohuri dhe promovon konceptet e të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale, mirëqenies ekonomike**

- Të kuptojë parimet e të drejtave, drejtësisë dhe mirëqenies ekonomike dhe rëndësinë e tyre në praktikë
- Të kuptojë dhe zbatojë në praktikë parimet e drejtësisë sociale, përfshirjes dhe barazisë.
- Të kuptojë se si legjislacioni dhe rregullat e udhëzimit mund të avancojnë ose të kufizojnë të drejtat e njerëzve dhe njohin se si ligji mund të përdoret për të mbrojtur ose për të promovuar të drejtat e tyre.
- Të punojë brenda parimeve të të drejtave civile dhe njerëzore si dhe brenda kufijve të legjislacionit duke diferencuar dhe duke filluar së punuari me të drejtat absolute, të kualifikuara dhe konkurruese si dhe duke diferencuar nevojat dhe perspektivat
- Të njohë ndikimin e varfërisë dhe të përjashtimit social dhe promovojë forcimin e statusit ekonomik përmes aksesit në arsim, punë, strehim, shërbime shëndetësore dhe përfitime të ndryshme sociale
- Të njohë vlerën e avokimit të pavarur dhe ndihmojnë në aksesimin e saj

#### **5. Reflektim dhe analizë kritike - Studenti aplikon reflektimin dhe analizën kritike për tuzhvilluar dhe për të siguruar një vetëdije vendimmarrëse profesionale**

- Të kuptojë rolin e praktikës reflektive dhe demonstrojë aftësi bazë reflektive
- Të njohë rëndësinë e aplikimit të imagjinatës, kreativitetit dhe kureshtjes për të praktikuar
- Të informojë vendimmarrjen nëpërmjet identifikimit dhe mbledhjes në informacion nga më shumë se një burim dhe me mbështetje të verë në pikëpyetje besueshmërinë dhe vlefshmërinë
- Të demonstrojë kapacitet për arsyetimin logjik, sistematik, kritik dhe reflektiv dhe aplikojë teorinë dhe teknikat e praktikës reflektuese
- Të dijë si të formulojë, testojë, vlerësojnë dhe shqyrtojnë hipoteza në përgjigje të informacioneve që kanë në dispozicion në atë kohë dhe t'i zbatojë ato në praktikë
- Të formulojë dhe ndër marrë vendime të qarta, gjykime të bazuara në fakte të informuara dhe vendime dhe të justifikuara

#### **6. Ndërrhyrja dhe aftësitë. Studenti përdor gjykimin dhe autoritetin profesional për të realizuar ndërhyrje ndaj individëve, familjeve dhe komuniteteve, për të promovuar pavarësinë, për të siguruar mbështetje dhe për të parandaluar dëmtimet, neglizhimin dhe abuzimin**

- Të demonstrojë aftësi bazë komunikative dhe kapacitet për t'i zhvilluar ato
- Të identifikojë dhe aplikojë një sërë metodash komunikimi verbale, joverbale dhe metoda të shkruara të komunikimi në përshtatje me moshën e personave, kuptueshmërinë dhe kulturën e tyre
- Të jetë në gjendje të komunikojë informacione, këshilla, udhëzime dhe opinione profesionale, si dhe të advokojë, ndikojë dhe bindë
- Të demonstrojë aftësinë për të qenë të angaxhur, për të ndërtuar, për të menaxhuar dhe për të përfunduar marrëdhënie në mënyrë të duhur dhe efektive
- Të demonstrojë një qasje holistike për identifikimin e nevojave, rrethanave, të drejtave, pikave të forta dhe rreziqeve të mundshme
- Të zgjedhë dhe të përdorë kornizat e duhura për të vlerësuar, për të mundësuar, planifikuar, zbatuar dhe shqyrtuar

ndërhyrjet efektive dhe për të vlerësuar rezultatet në bashkëpunim me përdoruesit e shërbimeve

- Të përdorë një qasje të planifikuar dhe të strukturuar, të informuar nga metodat, modelet për të promovuar ndryshime pozitive dhe të pavaruara si dhe për të parandaluar rreziqet
- Të njohë se si zhvillimi i burimeve të komunitetit, të grupeve dhe të rrjeteve rrit përfitimet përfundimtare të individëve
- Të mbajnë shënime të sakta, të kuptueshme dhe në kohë dhe të raportojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, protokollet dhe udhëzimet, në mbështetje të gjykimeve profesionale dhe përgjegjësisive organizative
- Të demonstrojë aftësi në shkëmbimin e informacionit në mënyrë të përshtatshme
- Të njohë ndryshimin e rrethanave, kompleksitetin dhe faktorët e shumtë, si dhe pasigurinë në jetën e njerëzve, që të jenë në gjendje për të përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve të tyre
- Të kuptojë autoritetin profesional dhe të fillojnë ta përdorë në mënyrë të përshtatshme si një profesionist i përgjegjshëm
- Me orientim të identifikojnë përgjigjet e duhura për të mbrojtur njerëzit e cenueshëm e vulnerabël dhe promovojnë mirëqenien e tyre

## Shtojca B: Formatet e vlerësimit

### Deklarata e konfidencialitetit

Për të ruajtur konfidencialitetin të gjitha emrat dhe faktorët e tjerë identifikues janë ndryshuar në këtë dosje. Këto përfshijnë emrat, adresat, emrat e familjarëve dhe kujdestarëve, emrat e profesionistëve, të pjesëtarëve të stafit dhe organizatave.

Në lidhje me ruajtjen e anonimitetit të përdoruesit të shërbimeve ose familjarëve të tyre unë kam përdorur (shënjo atë që ju përket):

Pseudonime ose inicialet

Fotokopjeosezvogëlim

Në rastet kur profesionistë të tjerë ose organizata e praktikës është përmendur me emër ose ka të dhëna që tregojnë autenticitetin e punës, leja për ti identifikuar ata është marrë dhe një deklaratë e firmosur nga ata që preken nga ky shqetësim është përfshirë në dosje.

### Firmat

Studenti	
Supervizori i institucionit	
Data	



## Raportimi i Vlerësimit të Praktikës

### SEKSIONI 1: Përmbledhje e vlerësimit dhe e të dhënave mbështetëse

#### Detaje të Praktikës

Studenti			
Supervizori i institucionit			
Pedagogu mbikëqyrës i praktikës			
Detaje mbi praktikën	Praktika Ma <input type="checkbox"/>	Të rritur <input type="checkbox"/>	Terren <input type="checkbox"/>
	Praktika Ba <input type="checkbox"/>	Fëmijë <input type="checkbox"/>	Ditor <input type="checkbox"/>
			Rezidencë <input type="checkbox"/>
Emri Institucioni			
Data e fillimit të Praktikës			

#### Vlerësimi final i praktikës

Rekomandimi	Kalon <input type="checkbox"/>	Nuk kalon <input type="checkbox"/>	Shtyhet <input type="checkbox"/>
Nënshkrimi i pedagogut të praktikës			
Nënshkrimi i studentit			
Nënshkrimi i supervizorit të institucionit			
Data			

### SEKSIONI 2: Raporti i vlerësimit sipas kompetencave profesionale

Kompetencat Profesionale	Nuk e plotëson aspak	E plotëson pjesërisht	E plotëson	E plotëson plotësisht	Shënime
<b>Kompetenca 1 – Profesionalizmi:</b> Studenti demonstroi përkushtim profesional, duke marrë përgjegjësi për sjelljen e tij, praktikën e të mësuarit me mbështetje përmes mbikëqyrjes.					
<b>Kompetenca 2 – Vlerat dhe Etika:</b> Aplikimi i parimeve dhe vlerave etike të profesionit për të udhëzuar profesionalisht praktikën.					
<b>Kompetenca 3 – Diversiteti:</b> Pranimit i diversitetit dhe aplikimi në praktikë i parimeve anti-diskriminuese dhe anti-shtypëse.					
<b>Kompetenca 4 – Të drejtat, drejtësia dhe mirëqenia</b>					

<p><b>ekonomike:</b> Advokimi i të drejtave të njeriut dhe promovimi i drejtësinë sociale dhe mirëqenies ekonomike</p>					
<p><b>Kompetenca 5 – Reflektim kritik dhe analizë:</b> Aplikimi i reflektimit kritik dhe analiza për të informuar dhe për të siguruar një vetëdije vendimmarrëse profesionale.</p>					
<p><b>Kompetenca 6 – Ndërhyrja dhe aftësitë:</b> Përdorimi i gjykimit dhe autoritetit për të realizuar ndërhyrje ndaj individëve, familjeve dhe komuniteteve për të promovuar pavarësinë, për të siguruar mbështetje dhe për të parandaluar dëmtimet, neglizhimin dhe abuzimin.</p>					

---

(Emër/Mbiemër, Firmë/Vulë)

### **Kalendari i ditëve të ndjekjes së praktikës**

Legjenda : P=Praktikë M= Mungesë L=Largim

Nr i javëve	Hë	Ma	Mër	Enj	Pre	Sht	Di	Totali ditëve
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								
Firma dhe data e studentit:								
Firma dhe data e Supervizorit të institucionit:								

**Nëse nuk e firmosni këtë fletë pjesëmarrjeje dhe nuk e vendosni në dosje ju do rezultoni jo kalues në lëndën e praktikës.**

## Shtojca C: Model reflektimi kritik mbi praktikën profesionale

### Studim rasti

#### Përshkrimi

Kam dy javë që po bëj praktikën time fillestare në një ekip për mbrojtjen e fëmijëve. Unë jam duke shoqëruar një punonjëse sociale gjatë një vizite në shtëpi. Kisha shumë ankth sepse doja të bëja një përshtypje të mirë, por përfundova duke ndarë informacion personal rreth vetes kur kisha pasur një eksperiencë të ngjashme me atë të klientit.

#### Ndjenjat



Figura. Balancimi i emocioneve/ ndjenjave komplekse

Ndjehem shumë konfuz tani. Ndjehem e ngazëllyer: Fola me një përdorues shërbimesh për herë të parë. Por ndjehem e humbur sepse ishte një katastrofë. Thjesht doja të zhdukesh dhe të zhytesha në kolltukun që isha ulur kur fillova të flas për veten time, nuk e ndaloja dot veten edhe pse e kuptoja që kjo ishte gabim.

## Vlerësimi

Tabela. Shembuj të mendimeve të mundshme kur reflektoni mbi praktikën	
Pozitive	Çfarë shkoi keq?
Isha veshur në mënyrë profesionale, telefonin e kisha fikur, ndjehesha e përgatitur	Ndava informacion personal me përdoruesin e shërbimeve dhe punonjës social
Vëzhgova se si punonjësi social fliste me klientin. Ajo ishte e relaksuar dhe e qartë. Do përpiqem edhe unë të jem e tillë kur do flas me përdoruesit e shërbimeve.	Nuk isha i qartë në lidhje me qëllimin e vizitës: isha aq i entuziazmuar për vitin time të parë në shtëpi sa që nxitova pa asnjë mëdyshje.
Kur po ktheheshim nga vizita, arrita ti thosha punonjës social që më vinte keq që kishte ndodhur një situatë e tillë.	Isha shumë në ankth ndaj gabova dhe shumë e përqendruar tek ankthi im sa që e humba toruan.

## Analiza

*Pse e prisha fare punën?* Në fakt, përdoruesi i shërbimeve kishte disa të përbashkëta me mua: moshë të njëjtë, histori të ngjashme, madje edhe kishim të njëjtin emër! Tani që reflektoj, shoh që e mbi-identifikova veten me klientin. Por, në disa mënyra, u ndjeva edhe disi e sigurt. Më pëlqente kolegja që më kishte marrë me vete. Kishim folur më parë për interesat tona, preferencat, planet e jetës etj, por tani kuptova që kufijjtë janë shumë të rëndësishëm në profesionin tonë (**Kompetenca 1: Profesionalizimi**). Henderson dhe Matheë-Bryne (2016) pohojnë se pasja e kufijve të ndarë personal nga ato profesional është një element i rëndësishëm por për një student në fillimet e tij është shumë e vështirë për të gjetur një balancë të drejtë. Kjo më bëri të ndjehem mirë: që është normale të gabosh, që të mësuarit nga kjo është më e rëndësishme. Tani kam filluar të kuptoj që përdoruesit e shërbimeve nuk janë miqtë e mi, as bashkëmoshatarët e mi. Unë jam aty për ti ndihmuar, ndaj do ishte mire të isha miqësor por jo shumë personal. Jo një linjë e thjeshtë për të ecur por po përpiqem ti eci (**Kompetenca 5: Reflektimi dhe analizë kritike**)



Figura 2. Shembull i diagramës merimangë mbi faktorët që kontribuojnë në ndërhyrje

## Përfundime

Ndjej që edhe pse kam ndarë informacion jo të përshtatshëm me përdoruesit e shërbimeve duke ndërprerë ndërhyrjen e punonjës social, jam në gjendje të reflektoj mbi arsyet pse e bëra këtë. Kam nevojë të zhvilloj një të

kuptuar mbi rëndësinë e kufijve personal dhe aftësinë për ti ndjekur ato.

**Pani i veprimit**

1. Kërko informacion/ këshillim nga fakulteti për të adresuar çështje personale.
2. Flit me superiorin se si ndjehesh, ndikimit të vizitës dhe ndikimit që mund të ketë në praktikë.
3. Flit me supervizorin rreth strategjive përballuese që mund të më ndihmojnë nëse situata shfaqet sërish.